



## FTESË PËR APLIKIM PËR MARRJE TË BANESËS ME QIRA

Në bazë të dispozitave të Nenit 26 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Banesore si dhe Nenit 9, 10 dhe 11 të **Rregullores mbi dhënien me qira të pasurive komerciale të Ndërmarrjes Publike Banesore, SH.A. Prishtinë**, Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. Prishtinë shpallë:

**Pasuria komerciale e cila ipet me qira:**

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi €/m2 (me TVSH)
1	Banesa në rrugën "Bill Clinton", Blloku 1, Hyrja 2, numër 21.	60.83 m2	1.50

**Përveç çmimit bazë, qiramarrësi do të paguaj shërbimet e mirëmbajtjes dhe obligimet komunale.**

Periodha e Qiradhënies është minimum 2 vit, me mundësi vazhdimi.

Qiramarrësi është i obliguar që para nënshkrimit të kontratës me qiradhënësin, të bëjë sigurimin e kontratës së qirasë për tre muaj më gjatë se vetë kontrata, në shumë prej katër qirave mujore neto. Banesa në fjalë është e pa mobiluara!

**Dokumentet administrative që duhet t'i dorëzuar nga aplikuesi:**

1. Aplikacionin për marrjen e pasurive komerciale me qira (mund ta merrni në hapësirat e NPB-së);
2. Numrin e xhirrollogarisë bankare të nënshkruar dhe vulosur nga banka.
3. Kopjen e një dokumenti identifikues të aplikuesit.
4. Çertifikatën e leshuar nga Gjykata jo më të vjetër se 6 muaj.
5. Fletëpagesën për aplikim.

Aplikacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në arkivën e Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A.. Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: emri i aplikuesit, nr. intern i patundshmërisë dhe kontaktet e aplikuesit (emaili dhe nr. i telefonit).

**Tarifa e aplikimit: 10 € (Euro).** Kont: BPB: 130 000 150 000 886 4. BKT: 190 946 698 103 119 4, NLB: 170 020 000 000 035 1.

**Aplikacionet nuk do të merren parasysh nëse:**

- Aplikuesi tashmë e ka një pasuri komerciale me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore SH.A.Prishtinë.
- Aplikuesi ka pasur një pasuri komerciale me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes;
- Nëse aplikacioni nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
- Nëse aplikacioni arrinë pas datës së skadimit të afatit të publikimit të shpalljes.

Personat të cilët duan t'i vizitojnë banesat me praninë e zyrtarëve të NPB-së, si dhe të kenë qasje në hapësirat e brendshme të tyre, këtë mund ta bëjnë me datën **10.01.2025** nga ora **09:00** deri në ora **12:00**.

**Afati për aplikim është i hapur nga data 31.12.2024 deri më date 15.01.2025**